



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 29 Janar 2022

Nr: 9

VENDIM

PËR

**“PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË PARTIVE
POLITIKE/SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, KONTROLLIN DHE VERIFIKIMIN E
FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja “f”, 63, pikat 1 e 2, 92/1, 92/2, 92/3 dhe 92/6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KOMISIONI RREGULLATOR

V E N D O S:

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka si objekt:

- a) përcaktimin e rregullave të veçanta për plotësimin, depozitimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare që dorëzojnë partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumëëmërore si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.
- b) miratimin e modeleve të raportimit për partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumëëmërore si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.



Data: 29 Janar 2022

Nr. 9

“Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

- c) miratimin e modelit të raportit të auditimit nga audituesët ligjorë të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për të kontrolluar raportet financiare për fushatën zgjedhore të subjekteve të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni,
- d) afatet për publikimin e raporteve,
- e) përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësisë të financierëve të subjekteve të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni.

Neni 2

Raportet e monitorimit

1. Monitoruesit e zgjedhjeve, të caktuar nga KQZ, për monitorimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të përcaktuar në shkronjën “a” të nenit 1 të këtij vendimi, me detyrimet sipas Kodit Zgjedhor dhe/ose akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dorëzojnë në KQZ:
 - a) raportin e ndërmjetëm çdo 10 (dhjetë) ditë nga fillimi i periudhës së monitorimit deri në ditën e zgjedhjeve,
 - b) raportin mbi shkeljen e vërejtur gjatë monitorimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore (të incidenteve) në të njëjtën ditë që bëhet vëzhgimi,
 - c) raportin përfundimtar të monitorimit, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas ditës së zgjedhjeve.
2. Raportet e ndërmjetme, të incidenteve dhe raporti përfundimtar i monitorimit publikohen në faqen e internetit të KQZ-së brenda 2 (dy) ditëve pune nga depozitimi i tyre në KQZ. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve publikon gjithashtu çdo masë apo vendim që ka marrë në lidhje me këto raporte.

Neni 3

Raporti Financiar për Fushatën Zgjedhore

1. Subjektet e përcaktuar në shkronjën “a” të nenit 1 të këtij vendimi duhet të depozitojnë në KQZ, raportin financiar për fushatën zgjedhore brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve. Raporti depozitohet në KQZ në një kopje fizike dhe një kopje elektronike.
2. Formatet e raporteve financiare për fushatën zgjedhore plotësohen sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi si më poshtë vijon:
 - a) shtojca nr. 1, për partitë politike;
 - b) shtojca nr. 2, për kandidatët për kryetar bashkie;
 - c) shtojca nr. 3, për kandidatët e listave shumëëmërore;
 - d) shtojca nr. 4, për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit;
 - e) shtojca nr. 5, për bilancin e asetëve të partisë politike, për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e zgjedhjeve.

3. Raporti financiar për fushatën zgjedhore publikohet në faqen e internetit të KQZ brenda 2 (dy) ditëve pune nga depozitimi i tij në KQZ.
4. Partitë politike publikojnë raportin në faqen e tyre zyrtare të internetit brenda 3 (tre) ditëve nga dorëzimi i tij në KQZ.

Neni 4

Kontrolli paraprak i raporteve financiare

1. Administrata e KQZ-së kryen kontrollin paraprak (prima facie) të raportit financiar për fushatën zgjedhore dhe njofton subjektet e përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi, nëse evidenton mangësi, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dorëzimi i tij.
2. Objekti i kontrollit paraprak të raportit financiar për fushatën zgjedhore është vetëm verifikimi i elementeve të formës juridike nëse janë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.
3. Në rastet kur janë evidentuar mangësi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, subjektet e përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi, jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë nga marrja e njoftimit nga KQZ, duhet të ridepozitojnë raportin e korrigjuar ose sipas rastit të depozitojnë shpjegimet përkatëse për mangësitë e konstatuara.
4. Raporti financiar për fushatën zgjedhore i korrigjuar, ose sipas rastit, shpjegimet e subjekteve të përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi, publikohen nga KQZ-ja në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas ridepozitimit të tij.

Neni 5

Raporti i Auditimit

1. Audituesi i përzgjedhur nga KQZ-ja për të kontrolluar fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga subjektet e përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi, gjatë fushatës zgjedhore, dorëzon raportin e auditimit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilitetit në kopje fizike dhe në formë elektronike në KQZ sipas afateve të përcaktuara në kontratë.
2. Raporti i auditimit hartohet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Raporti i auditimit publikohet në faqen e internetit të KQZ-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse.

Neni 6

Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare të partive politike/subjekteve zgjedhore

1. Administrata e KQZ-së ka të drejtë të verifikojë dhe kontrollojë respektimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij për fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga subjektet e përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi gjatë fushatës zgjedhore. Afati i verifikimit të raportit financiar për fushatën zgjedhore është jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit të tij në KQZ. Ky afat mund të shtyhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë të tjera, në rastet e kryerjes së hetimeve të thelluara ose kur raporti përmban çështje komplekse që kërkojnë kohë për verifikim.
2. Administrata e KQZ-së, pas marrjes së raporteve të auditimit bën verifikimin e raportit financiar për fushatën zgjedhore duke:
 - a. krahasuar të dhënat me gjetjet dhe përfundimet në raportin e auditimit për fushatën zgjedhore, raportin përfundimtar të monitorimit, si dhe çdo informacion tjetër të marrë gjatë hetimit administrativ si rezultat i ankesave, kërkesave apo denoncimeve lidhur me shkeljet e mundshme të Kodit Zgjedhor;
 - b. kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi në shtojcën nr. 7, respektimin e kufirit të lejuar të shumës së dhurimit, si dhe nëse shuma e dhurimit të fondeve jopublike mbi kufirin e përcaktuar është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim;
 - c. verifikuar nëse fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga kandidati për kryetar bashkie dhe kandidatët e listave shumëëmërore për fushatën zgjedhore janë deklaruar në raportin e dorëzuar nga partia politike/subjekti zgjedhor;
 - d. rillogaritur totalin e shpenzimeve të deklaruara gjatë fushatës zgjedhore dhe duke e krahasuar atë me kufirin e lejuar për financim të subjekteve të përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi.
3. Nëse nga krahasimi ndërmjet raportit financiar të subjekteve të parashikuara në nenin 1 shkronja “a” të këtij vendimi me raportin përkatës të auditimit për fushatën zgjedhore, rezulton se ka mospërputhshmëri, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve autorizon me shkrim kryerjen e verifikimeve të thelluara. Për qëllime të verifikimit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëron një riauditim nëpërmjet një audituesi të ri nga lista e ekspertëve kontabël të licencuar (audituesve ligjorë). Audituesi i ri, për përgatitjen e raportit ka të drejtë të:

- a. intervistojë persona dhe subjekte të ndryshme;
 - b. marrë informacion nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - c. këqyrë dokumente që lidhen me këto verifikime të thelluara pranë zyrave përkatëse të subjekteve të përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi;
 - d. marrë çdo lloj informacioni apo të dhënë tjetër nga institucionet shtetërore, bankat apo persona të tretë.
4. Audituesi i ri harton një raport përfundimtar dhe e dorëzon në KQZ brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
 5. Pas përfundimit të procesit të riauditimit, administrata e KQZ-së i paraqet Komisionerit një relacion përfundimtar ku parashtron gjetjet nga verifikimi dhe kontrolli, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme. Komisioneri, brenda 48 (dyzet e tetë) orësh nga marrja e relacionit, miraton me shkrim gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura ose në rast se nuk bie dakord me to bën refuzimin përkatës me shkrim, duke arsyetuar refuzimin për të dhënë miratimin.

Neni 7

Financieri

1. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 1, të këtij vendimi duhet të caktojnë një financier. Secili prej tyre nuk mund të caktojë më shumë se një financier në të njëjtën kohë.
2. Financieri nuk duhet të jetë kandidat për t’u zgjedhur.
3. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 1 ndërpresin marrëdhëniet me financierin dhe emërojnë një financier të ri në rastet kur financieri:
 - a. bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
 - b. dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
 - c. ka papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së financierit sipas pikës 2 të këtij neni;
 - d. është në kushtet e konfliktit të interesave në raport me KQZ;
 - e. jep dorëheqjen;
 - f. vdes.
4. Në rastin kur financieri jep dorëheqjen, ai duhet të njoftojë me shkrim subjektin zgjedhor që e ka caktuar dhe KQZ-në. Financieri ndërpret funksionin e tij dhe me procesverbal organizon transferimin e informacionit dhe dokumentacionit financiar të subjekteve të përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi te financieri i emëruar. Subjekti zgjedhor i përcaktuar në nenin 1,

shkronja “a” të këtij vendimi njofton me shkrim KQZ-në për emërimin e financierit të ri, jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e emërimit.

5. Financieri i subjektit zgjedhor të përcaktuar në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë që kryen në menaxhimin e financave ose për mosrespektim të legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Përgjegjësitë e financierit

Financieri i subjekteve të përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 1, të këtij vendimi ka këto përgjegjësi:

1. administron veprimtarinë financiare të fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor të përcaktuar në shkronjën “a” të nenit 1, të këtij vendimi dhe veprimtarinë financiare vjetore të partisë politike sipas rastit;
2. regjistron të gjitha transaksionet financiare, si dhe gjurmon çdo shpenzim dhe/ose kontribut në natyrë;
3. ndjek hapjen dhe deklarimin e llogarisë bankare, në momentin e regjistrimit si parti politike dhe siguron që dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë të bëhet vetëm në llogari të posaçme të hapura në banka nga subjektet e përcaktuara në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi;
4. administron të gjithë aktivitetin financiar për fushatën zgjedhore të kandidatit për kryetar bashkie dhe kandidatët e listave shumëemërore të partisë politike të vënë në dispozicion nga këta të fundit;
5. mbledh dhe siguron arkivimin/ruajtjen e duhur të të gjithë informacionit dhe dokumenteve mbështetëse në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore nga subjekti i përcaktuar në nenin 1, shkronja “a” të këtij vendimi, përfshirë faturat, mandat pagesat, deklaratat bankare, informacionin që mbështet vlerësimin e dhurimeve në natyrë dhe deklaratat e dhuruesve;
6. kontrollon të gjitha burimet e të ardhurave, duke u siguruar se:
 - a. origjina e të ardhurave, atyre monetare dhe në natyrë, është nga dhurues të ligjshëm dhe të lejur nga ligji;
 - b. vlerësimi i dhurimeve në natyrë është kryer si duhet;
 - c. nuk janë tejkualuar kufijtë në dhurime;
7. kontrollon të gjitha shpenzimet e fushatës zgjedhore përfshirë ato të kandidatit për kryetar bashkie dhe kandidatët e listave shumëemërore që përfshihen në llogaritë e subjektit zgjedhor

duke vlerësuar mostejkalimin e kufirit të shpenzimeve, sipas nenit 92/2, pikat 4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor;

8. mban dhe ruan në arkiv për një periudhë prej 7 (shtatë) vjetësh dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm të statusit financiar të partisë politike dhe të degëve të saj, sipas nenit 92/3, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Formati i regjistrit të dhurimeve të përfituara nga subjekti zgjedhor për fushatën zgjedhore do të mbahet sipas shtojcës nr. 8 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
9. dorëzon raportin financiar për fushatën zgjedhore duke u kujdesur që të jetë i saktë, i plotë dhe i depozituar në kohë në KQZ;
10. jep ose siguron që t'i kthehet përgjigje në mënyrë të plotë dhe në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitura nga audituesi apo KQZ-ja.

Neni 9

Përgjegjësitë e kandidatëve të listave shumëemërore dhe kandidatëve për kryetar bashkie

1. Kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie kanë detyrimin të mbajnë kontakte të shpeshta me financierin dhe të ndjekin udhëzimet e dhëna prej tij për dokumentimin e fondeve dhe të shpenzimeve që kryejnë gjatë fushatës zgjedhore.
2. Kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie kanë detyrim të dorëzojnë tek financieri brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjedhjeve dokumentacionin për fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera prej tij gjatë fushatës zgjedhore.
3. Financieri përgjigjet për dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia për shkeljen i ngarkohen kandidatit të listës shumëemërore/kandidatit për kryetar bashkie.
4. Shuma e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit regjistrohen në modelet e deklarimeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
5. Kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie, nëse nuk kanë hapur llogarinë e posaçme në momentin e regjistrimit atëherë, nga momenti i hapjes së llogarisë së posaçme për pranimin e dhurimeve, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e zgjedhjeve, duhet ta deklarojnë atë menjëherë në KQZ.

Neni 10

Sanksionet

Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të Kodit Zgjedhor.

Neni 11

Shfuqizim

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, dispozitat e vendimit nr. 256, datë 08.05.2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore shfuqizohen.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

Shtojca 1

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Model i miratuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator

Periudha e raportimit: *gjashtë muaj para fillimit të fushatës zgjedhore dhe periudha e fushatës zgjedhore*

Në bazë të Kodit Zgjedhor (neni 92/3), të gjitha subjektet zgjedhore duhet të raportojnë për donacionet dhe shpenzimet e kryera për qëllime të fushatës zgjedhore, dhe duhet të mbajnë dhe dorëzojnë edhe dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar këtë format të standardizuar për raportim, i cili detajon të gjithë informacionin që duhet të dorëzohet nga subjektet zgjedhore. Ky format tip i standardizuar do të dorëzohet si në versionin elektronik me anë të emailit në adresën e shënuar më poshtë, ashtu edhe i printuar, pranë Drejtorisë së Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm të KQZ-së.

Ky format raportimi konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata
 - 2.a Të ardhura - Financime publike
 - 2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
 - 2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
 - 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike
3. Huatë dhe Kreditë
4. Shpenzimet e partisë
 - 5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore
 - 5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për njësitë e qeverisjes vendore
6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.
Tabela "**Referenca**" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet dorazi tek Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm në KQZ dhe gjithashtu me email në adresën: Valbona.Ballgjini@kqz.gov.al

1. Informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata

Pjesa A - Informacion për subjektin zgjedhor

Emri i plotë i subjektit i zgjedhor:

Numri i regjistrimit (Neni 9 i Ligjit për partitë politike):

Adresa e selisë së subjektit zgjedhor

Emri/Mbiemri i personit përgjegjës për financat

Adresa e emailit e personit përgjegjës për financat

Numri i telefonit të personit përgjegjës për financat

Pjesa B - Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
a. Totali i të ardhurave nga fondet publike	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga persona juridike	ALL	-
d. Totali i të ardhurave nga kandidatët për kryetarë	ALL	-
e. Totali i të ardhurave nga kandidatët e listave	ALL	-
e. Totali i të ardhurave të krijuara nga vetë partia	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i shpenzimeve të bëra nga partia	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët për kryetarë	ALL	-
c. Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët e listave	ALL	-
d. Totali i shpenzimeve indirekte	ALL	-
e. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

Pjesa C - Deklarata

Duke qenë i/e vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme, në bazë të njohurive të mia më të mira dhe me përgjegjësi për përgatitjen e këtij raporti, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Firma e personit përgjegjës për financat/përgatitur nga:

Data e firmosjes:

Aprovuar/Miratuar nga:

Data e firmosjes:

2.a Të ardhura - Financime publike

Shuma e fondeve publike të përfituara në përputhje me nenet 88 dhe 89 të Kodit Zgjedhor

- Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit (sipas nenit 88)
- a Data e marrjes së fondit nga Buxheti i Shtetit
- Diferenca e kthyer (nëse ka, sipas nenit 88, pika 7)
- Data e kthimit të diferencës
- b Kompensimi financiar paszgjedhor (neni 89)
- Data e marrjes së kompensimit financiar paszgjedhor

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:

Data e firmosjes:

Aprovuar/Miratuar nga:

Data e firmosjes:

2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

A. Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura

B. Shuma e të ardhurave

C. Data në të cilën janë depozituar të ardhurat

D. Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat

E. Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat

F. Të ardhura të krijuara nga:

G. Emri i degës (nëse është i aplikueshëm)

H. Përshkrimi

3. Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Huatë dhe Kreditë

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

											Termat		
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rresht 1)	D. Adresa e huadhënësit (rresht 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kredisë	H. Shuma e huasë/limiti i kredisë	I. Data e fillimit të huasë/kredisë	J. Norma e interesit	K. Data e shlyerjes	L. Kolateralit i ofruar		

5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore

Firma e personit përgjegjës/Përgatituesi:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

- A. Bashkia B. Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetarë të sipas secilit njësi të qeverisjes vendore C. Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetarë sipas secilit njësi të qeverisjes vendore

Beish
Berat
Bulqizë
Cërrik
Delvinë
Devoll
Dibër
Divjakë
Dropull
Durrës
Elbasan
Fier
Finiq
Fushë Arrëz
Gjrokastrë
Gramsh
Has
Himarë
Kamëz
Kavajë
Këlcyrë
Klos
Kolonjë
Korçë
Krujë
Kuçovë
Kukës
Kurbn
Lezhë
Libohovë
Librazhd
Lushnjë
Maliq
Maliq
Maliq
Mat
Memaliaj
Mirditë
Patos
Peqin
Përmet
Pogradec
Polican
Prenjas
Pukë
Pustec
Roskovec
Rrogozhinë
Sarandë
Selenicë
Shjak
Shkodër
Skrapar
Tepelenë
Tiranë
Tropojë
Ura Vajgurore
Vau i Dejës
Vlorë
Vorë

5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për njësitë e qeverisjes vendore

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për njësitë e qeverisjes vendore

Firma e personit përgjegjës/Përgatituesi:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratur nga:	
Data e firmosjes:	

A. Bashkia

B. Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore

C. Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore

- Belsh
- Berat
- Buqizë
- Cërrik
- Delvinë
- Devoll
- Dibër
- Dijakë
- Dropull
- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Finiq
- Fushë Arëz
- Gjirokastrë
- Gramsh
- Has
- Himari
- Kamëz
- Kavajë
- Këlcyrë
- Klos
- Kolonjë
- Korçë
- Korçë
- Krujë
- Kuçovë
- Kukës
- Kurbin
- Lezhë
- Litohovë
- Librazhd
- Lushnjë
- Malisë e Madhe
- Maliq
- Mallakastrë
- Mat
- Memaliaj
- Mirditë
- Patos
- Peqin
- Përmat
- Pogradec
- Polican
- Prrenjas
- Pukë
- Pustec
- Roskovec
- Rrogozhinë
- Sarandë
- Selenicë
- Shijak
- Shkodër
- Skrapar
- Tepelenë
- Tiranë
- Tropojë
- Ura Vajguore
- Vau i Dejës
- Vlorë
- Vorë

6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

A. Mitingjet e fushatës

B. Kategoritë e shpenzimeve për mitingje

C. Kostoja

Lloji i zgjedhjeve	Lloji dhurimit	Statusi i dhuruesit	Metoda e dhurimit	Lloji i shpenzimit	Lloji i medias	Po, Jo
Parlamentare Lokale	Dhurime monetare Dhurime në natyrë Të ardhura të krijuara nga subjekti	Person fizik Person juridik Entitet juridik	Para në dorë/cash Çek bankar Transferetë bankare Kartë krediti/debiti	Mirënjohje dhe aktivitet Materiale promovionale Media Media sociale Sondazhe Botime/Publikime Transporti Konsulenca Reklamime në natyrë Shpenzime zyre elektorale Shpenzimet administrative	TV Radio Printime Online	Po Jo

Data më e hershme	Marrë nga	Aktiviteti që ka krijuar të ardhura	Të pa raportueshme	Kategoria e shpenzimit	Kategoria shpenzimeve të fushatës	Listatim i gjedve dinamike	Kryer nga	Qarku
01/01/2017	Zyra qendrore Deqa	Shitja e pronave Shitja e publikimeve Dhënia me qera Interesa bankare Kuotat e anëtarësisë Transferetë nga ilogarisë e partisë Të tjera (specifikoni në kolonën e fundit)	Të dhënat e mëposhtme Konfirmoj se nuk kemi zëra për të raportuar	Zërat e shpenzimeve monetare Shpenzime të pasqyruara Detyrime financiare	Shpenzime për vendin/ambjentin Shpenzime për zbatim/organizim Shpenzime për pajisje Shpenzime për reklama/promocion Shpenzime për transport Shpenzime administrative		Zyra qendrore Deqa	Belsh Bërsh Bulqizë Cërrik Delvinë Devoll Dibër Dijakë Dropull Durrës Elbasan Fier Fierç Fushë Arrëz Gjrokastrë Gramsh

Shtojca 2

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore

Model i miratuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator

Periudha e raportimit: *gjathtë muaj para fillimit të fushatës zgjedhore dhe periudha e fushatës zgjedhore*

Secili kandidat për kryetar për njësitë e qeverisjes vendore, duhet të raportojë për donacionet dhe shpenzimet e kryera për qëllime të fushatës zgjedhore, dhe duhet të mbajë dhe të dorëzojë edhe dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar këtë format tip për raportim, i cili detajon të gjithë informacionin që duhet të dorëzohet nga kandidatët për kryetarë për njësitë e qeverisjes vendore pranë partive politike që ata i përkasin. Ky raport do t'i dorëzohet Kryefinancierit të partisë tuaj në format elektronik dhe të printuar, ndërkohë që dokumentacioni mbështetës duhet të dorëzohet i printuar.

Ky format tip konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Informacion për kandidatin, përmbledhje financiare dhe deklarata
 - 2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike
 - 2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
 - 2.c Huatë dhe Kreditë
3. Shpenzime
4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.

Tabela "**Referenca**" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet tek Kryefinancierit i Partisë tuaj brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

1. Informacion për kandidatin, përmbledhje financiare dhe deklarata

Pjesa A - Informacion për kandidatin

Emri i plotë i kandidati:

--

Bashkia

--

Emri/Mbiemri i personit përgjegjës për financat (nëse është i ndryshëm nga kandidati)

--

Adresa e emailit e personit përgjegjës për financat

--

Numri i telefonit të personit përgjegjës për financat

--

Pjesa B - Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga persona juridike	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i pagesave të bëra	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve indirekte	ALL	-
c. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

Pjesa C - Deklarata

Duke qenë i/e vetëdijshëm se raporti im do jetë pjesë e raportit të subjektit zgjedhor që unë përfaqësoj dhe për pasojat ligjore në rast të deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme, në bazë të njohurive të mia më të mira dhe me përgjegjësi për përgatitjen e këtij raporti, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Firma e personit përgjegjës për financat /përgatitur nga: (nëse ka)

--

Data e firmosjes:

--

Firma e kandidati:

--

Data e firmosjes:

--

2.c Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.c Huatë dhe Kreditë

Firma e personit përgjegjës për financat /përgatitur nga: (nëse ka)	
Data e firmosjes:	
Firma e kandidatit:	
Data e firmosjes:	

										Termat	
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	D. Adresa e huadhënësit (rreshti 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kredisë	H. Shuma e huasë/fimit i kredisë	I. Data e fillimit të huasë/kredisë	J. Niveli i interesit	K. Data e shyerjes	L. Kolateralit i ofruar

3. Shpenzime

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Shpenzime

Firma e personit përgjegjës për financat (përgjigjet nga: inëse ka)	
Data e firmosjes:	
Firma e kandidatit:	
Data e firmosjes:	

A. Kategoria e shpenzimeve	B. Shitësi/furnizuesi të faturs	C. Nr identifikimit të faturs	D. Data e faturs	E. Data e pagesës	F. Shuma e paguar	G. Shuma e papaguar (nëse ka)	H. Metoda e kryerjes së pagesës	I. Shpjegimi	J. Sipas bashkive	Shpenzimet e zyrtë elektorale	Materiale promotionale/Media Sociale/Sondazhe/Publikim e dhe reklama/Transport/Reklamim K. Përkrahimi	Media	L. Ujqi i medias	M. Përkrahimi
Mitinge/hubime dhe aktivitate në fushatë														

4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Firma e personit përgjegjës/Përgatitur nga:	
Data e firmosjes:	
Aprovuar/Miratuar nga:	
Data e firmosjes:	

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

A. Mitingjet e fushatës

B. Kategoritë e shpenzimeve për mitingje

C. Kostoja

Uloji_i_zgjedhjeve	Uloji_dhurimit	Statusi_i_dhuruesit	Metoda_e_dhurimit	Uloji_i_shpenzimit	Uloji_i_medias	Po_Jo
Parlamentare Lokale	Dhurime monetare Dhurime në natyrë Të ardhura të krijuara nga subjekti	Person fizik Person juridik Entitet juridik	Para në dorë/cash Çek bankar Transfer të bankare Kartë krediti/debiti	Mitingje/tubime dhe aktivitet Materiale promovionale Media Media Sociale Sondazhe Botime/Publikime Transporti Konsulenca Reklamime në natyrë Shpenzime zyre elektorale Shpenzimet administrative	TV Radio Printime Online	Po Jo

Data më e hershme	Marrë nga	Aktiviteti që ka krijuar të ardhura	Të pa raportueshme	Kategoria e shpenzimit	Kategoria shpenzimeve të fushatës	Listamitingjevedinamike	Qarku
01/01/2017	Zyra qendrore Dega Kandidati	Shitja e publikimeve Dhënia me qera Interesa bankare Kuotat e anëtarësisë Të tjera (specifikoni në kolonën e fundit)	Të dhënat e mëposhtme Konfirmoj se nuk kemi tëra për të raportuar	Zërat e shpenzimeve monetare Shpenzime të papaguara Detyrime financiare	Shpenzime për vendin/ambientin Shpenzime për çabujtje/argëtim Shpenzime për pajisje Shpenzime për pajje Shpenzime për reklama/promocion Shpenzime për transport Shpenzime administrative		Bëish Berot Bulqizë Cërrik Delvinë Devoll Dibër Divjakë Dropull Durrës Elbasan Fier Finiq

Shtojca 3

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët në listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Model i miratuar me vendim nr. 9 datë 29.01.2022 të Komisionit Rregullator

Periudha e raportimit: *gjathtë muaj para fillimit të fushatës zgjedhore dhe periudha e fushatës zgjedhore*

Secili kandidat në listën shumëemërore të çdo subjekti zgjedhor, duhet të raportojë për donacionet dhe shpenzimet e kryera për qëllime të fushatës zgjedhore, dhe duhet të mbajë dhe të dorëzojë edhe dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar këtë format tip për raportim, i cili detajon të gjithë informacionin që duhet të dorëzohet nga kandidatët në listat shumëemërore, pranë partive politike që ata i përkasin. Ky raport do t'i dorëzohet Kryefinancierit të partisë tuaj në format elektronik dhe të printuar, ndërkohë që dokumentacioni mbështetës duhet të dorëzohet i printuar.

Ky format tip konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Informacion për kandidatin, përmbledhje financiare dhe deklarata
 - 2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike
 - 2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
 - 2.c Huatë dhe Kreditë
3. Shpenzime

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni. Tabela "**Referenca**" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet tek Kryefinancierit i Partisë tuaj brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

1. Informacion për kandidatin, përmbledhje financiare dhe deklarata

Pjesa A - Informacion për kandidatin

Emri i plotë i kandidati:

--

Bashkia

--

Emri/Mbiemri i personit përgjegjës për financat (nëse është i ndryshëm nga kandidati)

--

Adresa e emailit e personit përgjegjës për financat

--

Numri i telefonit të personit përgjegjës për financat

--

Pjesa B - Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga persona juridike	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i pagesave të bëra	ALL	-
